


REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	2-D /DPK
Dep.	
Nr. i faq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	01-3362/13
Br. Prot.	
Prot No.	
Data	
Datum	14.10.2013
Date	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d) si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.10.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Mbylllet rasti** me nr. AKK- 03-2639/13, për z. **Ibrahim Rrustemi** – Drejtor i Administratës dhe i Mbështetjes në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

- I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr.AKK- 03-2639/13, për Zyrtarin e Lartë, z. Ibrahim Rrustemi. Drejtor i Administratës dhe i Mbështetjes në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Rrustemi është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (me datë 10.09.2013), pas së cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet të bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Rrustemi, në këtë takim ka deklaruar se brenda asfatit ligjor do të deq dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznes privat dhe do të vazhdoj të ushtroj funksionin e tij publik.

Ndërkojë, z. Rrustemi ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjencionii për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03-3161/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga pozita e personit të autorizuar që kishte në N.I.SH "Euro Rrustemi", për të ushtruar funksionin e tij publikë, si Drejtor i Administratës dhe i Mbështetjes në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, me çka ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik;
- Drejtorit të DPK-së ;
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës).

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

